



Pranuar / Doretuar / Priljeho / Prudato Received / Delivery	26 - 10 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHA	6479/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.751/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.751/2022 të datës 31.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Prishtinë, kundër organit të punësimit/ Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 25.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e bazuar ankesa A.nr.751/2022 e datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, më datë 31.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5044/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër refuzimit për trajnimin profesional nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa ky i fundit më datë 07.09.2022 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me Vendimin VK.Nr.122/2022 të datës 13.10.2020 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është shtyrë afati për vendosje lidhur me këtë çështje

administrative në pajtim me nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5044/2022 të datës 31.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Air Transport Economics" të periudhës kohore 12.11.2018 deri me 16.11.2018; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "ANSP-s" për periudhën kohore 18.03.2019 deri me 22.03.2019; Certifikatën me numër ECVET: 52 me të cilën ankuesi ka fituar titullin Teknik i Kontabilitetit; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Laë of Aviation Insurance-Virtual Classroom" për periudhën kohore 04.11.2020 deri me 06.11.2020; Kërkesën me referencë: AACK/BNJ/TRN të datës 23.08.2022 lidhur me aprovimin e ndjekjes së trajnimit Profesional; Manualin e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit BNRREA-MAN/ver.4/15 Mars.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5069/2022 të datës 01.09.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5198/2022 të datës 07.09.2022; E-malin e datës 23.08.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ -malin e datës 23.08.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-malin e datës 09.08.2022 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-malin e datës 09.08.2022 nga \_\_\_\_\_ E-malin e datës 08.08.2022 nga \_\_\_\_\_ E-malin e datës 03.08.2022 nga \_\_\_\_\_ për Rregulloren Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve; Vendimin me numër protokollit 3669/2022 të datës 23.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër VK.nr. 53/2022 të datës 08.06.2022; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 2950/2022 të datës 20.05.2022; Kërkesën për përgjigje me numër të protokollit 2649/2022 të datës 06.05.2022; Ankesën e ankuesit të parashtruar në KPMSHCK me datën 26.04.2021; Kërkesën me numër Ref: AACK/BNJ/TRN të datës 13.05.2022 lidhur me aprovimin e ndjekjes së trajnimit profesional; Emailin e datës 13.05.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Listën e datës 01.03.2017 lidhur me përfundimin e trajnimeve të ankuesit; Kërkesën me numër Ref: AACK/BNJ/TRN të datës 04.04.2022 lidhur me aprovimin e ndjekjes së trajnimit profesional; E-malin e datës 06.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-malin e datës 04.04.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 4598/21 të datës 20.09.2021; E-mailin e datës 22.10.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-mailin e datës 22.10.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 21.10.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 19.10.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 18.10.2021 nga \_\_\_\_\_ për CAA Staff; E-mailin e datës 28.09.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 27.09.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 30.07.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ E-malin e datës 29.07.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 29.07.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-mailin e datës 29.07.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 29.07.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-mailin e datës 28.06.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 24.06.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 21.08.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-maili i datës 24.08.2021 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 11.08.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-malin e datës 11.08.2021 nga ankuesin për \_\_\_\_\_ E-malin e datës 29.07.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; Aprovimin e trajnimit profesional me referencë: AACK/BNJ/TRN të datës 27.09.2021 lidhur me aprovimin e ndjekjes së trajnimit profesional; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4598/2021 të datës 13.09.2021; Ankesën

me numër të protokollit 4557/2021 të datës 09.09.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emerimin e ankuesit të datës 01.03.2018; Përshkrimin e detyrave të punës së datës 13.06.2017 të ankuesit; Planin e Trajnimeve për vitin 2021; Kërkesën me referencë AACK/ADM/TRN/6 të datës 28.06.2020 për Aprovimin e Trajnimeve Profesionale; Kërkesën me referencë AACK/ADM/TRN/6 të datës 29.07.2021 për Aprovimin e Trajnimeve Profesionale; Emailin e datës 02.08.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 30.07.2021 nga për ankuesin; Emalin e datës 29.07.2021 nga ankuesin për E-mailin e datës 29.07.2021 nga për ankuesin; E-mailin e datës 28.07.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 28.07.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 24.06.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 10.08.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 10.08.2021 nga për ankuesin; E-mailin e datës 09.08.2021 për ankuesin; E-mailin e datës 03.09.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 31.08.2022 nga për ankuesin; E-mailin e datës 24.08.2021 nga JAA TO Accountin Dept për ankuesin; draft-Plani i trajnimeve për vitin 2022; Vendimin VK.Nr.122/2022 i datës 13.10.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e lëndës, ka konstatuar se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, SEPSE:

Nga administrimi i provave materiale gjegjësisht sipas Akt-it të Emërimit të datës 01.03.2018 rezulton së ankuesi është i emëruar dhe ushtron pozitën e punës "Zyrtar për Rregullimin Ekonomik të Aeroporteve dhe Shërbimeve të Navigacionit Ajror" në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji gjen se ankuesi disa herë radhazi ka parashtruar kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për aprovim të trajnimit "Auditing Techniques", ndërsa pas mos aprovimit të kërkesës së fundit të parashtruar më datë 23.08.2022, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos aprovimin e ndjekjes së trajnimit profesional duke pretenduar së refuzimi i trajnimit profesional përbën shkelje të të drejtave të ankuesit të garantuar me nenin 23 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe së mos aprovimi i trajnimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm paraqet qasje subjektive dhe se me këto veprime ka deskrimnuar ankuesin, sepse sipas ankuesit i njëjti ka ndjekur katër (4) trajnimet për të fituar kredencialet për inspektor të rregullimit ekonomik, ndërsa trajnimi "Auditing Techniques" është trajnimi i fundit.

Në përgjigjen në ankesë, Udhëheqësja e Njesisë së Personelit deklaron së në vitin 2022 Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka të miratuar Planin e trajnimeve kështu që pa pasur një plan të trajnimeve të miratuar atëherë edhe nuk mund të realizohet një trajnimi i kërkuar nga ankuesi për shkak të kostos buxhetore.

Kolegji në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore, i'u referua nenit 23 të Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtën të përmirësojnë aftësitë profesionale për vendin e punës nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, nga donatorë të huaj apo nga të ardhurat vetanake", si dhe nenit 15 po të të njëjtit ligj më të cilin është paraparë se: " 1. Çdo institucion, që merr në punë zyrtarë publikë, është i obliguar të përgatisë planin vjetor dhe afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor. 2. Planifikimi i personelit bëhet me qëllim që të sigurohet personel adekuat, me njohuri,

aftësi dhe cilësi të nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin e vazhdueshëm të institucionit dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë. 3. Planet e personelit hartohen për të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë dhe duhet të përmbajnë: 3.1. një analizë për nevojat e personelit, bazuar në karakteristikat aktuale të stafit dhe prioritetet e institucionit dhe të Qeverisë; 3.2. një analizë e mënyrave për përmbushjen e këtyre nevojave; 3.3. zhvillimin profesional të stafit ekzistues dhe nevojat për trajnim të personelit; 3.4. lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë; 3.5. krijimin e vendeve të reja, të lira, të punës, si dhe afatet e plotësimit të tyre. mirëpo kjo mund të bëhet në bazë të planit të trajnimeve të arsyetuar edhe me kosto buxhetore....

Po ashtu Kolegji për vendosje meritore lidhur me këtë çështje juridike-administrative ka analizuar aktet e brendshme ligjore të Autoritetit të Aviacionit Civil, përkatësisht:

Rregulloren Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve, Neni 2 pika a ka përcaktuar se: "Kredenciale- nënkupton: Llojin e kualifikimeve të veçanta në lidhje me kompetencat e AAC-së, i cili i jep bartësit të saj disa të drejta të caktuara dhe obligime në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil..." ndërsa "Inspektor-nënkupton një nëpunës të AAC-së të cili i është akorduar ky titull pas plotësimit të disa kushteve të nevojshëm të cilat janë përcaktuar në manualin përkatës dhe në përputhje me procedurat e përshkruara me manualin e cilësisë, të cilit i jepet e drejtë të kryej detyra të veçanta mbikëqyrjeje të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil", neni 5, përcakton se: Drejtori i përgjithshëm është autoriteti aprovuës për dhënien e kredencialeve. Departamenti i Administratës do të administrojë procesin e lëshimit dhe kontrollit të kredencialeve të lëshuara".

Manualin e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit, Pika 2.4 thuhet: "Drejtori i përgjithshëm është autoriteti aprovuës për lëshimin e kredencialeve të IRREA-së, Pika 2.6 punonjësit të AAC-së përcakton: Punonjësit të AAC-së do t' lëshohen kredencialet e IRREAS-së me kusht që ai/ajo të ketë përmbushur kriteret e përshtatshmërisë në lidhje me edukimin, kualifikimin dhe trajnimin e përcaktuar me poshtë në këtë paragraf: a) Të përmbush kualifikimet në përputhje me paragrafin 2.7 të këtij manuali dhe paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.2/2011 dhe b) Të ketë plotësuar kërkesat e trajnimit në përputhje me paragrafin 2.8 të këtij manuali, Pika 2.8 : " Qëllimi i trajnimit është që të siguroj kandidatin e njohuri bazë të ekonomisë së aviacionit, të cilat do t'i mundësojnë atij/asaj qëndrueshmërinë ekonomike të operatorëve dhe detyrat tjera. Njohuri të tilla mund të sigurohen nëpërmjet një kombinimi të kurseve formale të trajnimit dhe trajnimit në vendin e punës. Trajnimet që duhet të përfundohen para lëshimit të kredencialit të IRREAS-së përfshihen në programin e mëposhtëm të trajnimit të ofruar nga çdo institucion i njohur nga ACC-ja për aq sa është e mundur nga ofertat e trajnimeve, mundësitë financiare të ACC-së dhe e nevojshme nga prapavija e zyrtarit që synon kredencialin: 1. Së paku 3 muaj trajnim në vendin e punës për procedurat administrative në AAC; 2. Trajnim për kontabilitet; 3. Trajnim për rregullimin ekonomik të aeroportëve; 4. Trajnim për rregullimin ekonomik të shërbimeve të navigacionit ajror; 5. Trajnim për sigurimin nga rreziku (insurance) të aviacionit; trajnim për teknikat e auditimit Punonjësi i ACC-së që kërkon kredencialet e inspektorit duhet të ketë një kontratë punësimi me një afat fillestar prej jo më pak se një vit, të posedojë diplomë universitare nga fusha ekonomike ose diplomë universitare në ndonjë fushë tjetër..."

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit duku u bazuar në kuadrin ligjor të sipër cekur, vlerëson se Autoriteti Aviacionit Civil bart përgjegjësinë ligjore që të bëjë planifikime lidhur me nevojat e stafit gjegjësisht inspektorëve të aviacionit civilë dhe këto planifikime ti përcaktoj në kuadër të Planit Vjetor dhe Afatmesëm të Personelit, si dhe mbi bazën e planifikimeve të tilla të siguroj kurse

trajtime në përshtatshmëri me kërkesat e përcaktuara me aktet e brendshme ligjore për dhënien e kredencialeve. Ndërlidhur me këtë konstatim, e në mungesë të planifikimeve të tilla nga Autoriteti i Aviacionit Civil si dhe duke qenë së pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi lidhur me aprovimin e ndjekjes së trajtime për marrje të kredencialeve të inspektorit të aviacionit civil, Kolegji vlerëson së mbi bazën e këtyre rrethana janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurë e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.751/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhiqaj-DEMI**

*Ardita Haxhiqaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.